

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 53488/15

**Francesco BECCHETTI dhe të tjerët
kundër Shqipërisë**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 26 shtator 2023, si Komitet i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *President,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 53488/15) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”), më 21 tetor 2015 nga kërkuesit e listuar në tabelën bashkëlidhur (“kërkuesit”) të përfaqësuar nga z. A. Saccussi, avokat i licencuar në Romë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë (“Qeveria”) të përfaqësuar fillimisht nga agjentja znj. A. Hiçka, dhe më pas nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit; parashtrimet e depozituara nga Qeveria e paditur dhe prapësimet e paraqitura nga kërkuesit; faktin që Qeveria Italiane nuk ka kërkuar të ushtrojë të drejtën e saj për të ndërhyrë (neni 36 § 1 i Konventës dhe Rregulli 44 § 1 i Rregullores së Gjykatës);

komentet e depozituara nga Res Publica që iu dha leje të ndërhyjë nga Presidenti i Seksionit;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

A. Faktet e çështjes

72. Çështja ka të bëjë me dy probleme: ankimimi i kërkuesit të katërt sipas nenit 3 të Konventës për vendosjen e prangave në seancë; dhe disa deklarata të Kryeministrit për të cilat kërkuesit pretendojnë se bien në kundërshtim me të drejtën e tyre për prezumimin e pafajësisë.

73. Kërkuesit janë aksionerë në disa shoqëri tregtare. Kërkuesi i parë është gjithashtu pronar i “Agon Channel”, një kanal televiziv privat që transmeton në Shqipëri dhe Itali. Kundër kërkuesve ka filluar procedimi penal me akuzën e falsifikimit të dokumenteve dhe pastrimit të parave.

74. Në seancën e mbajtur më 9 qershor 2015, në lidhje me një masë sigurimi të vendosur ndaj kërkueses së katërt, ajo u shoqërua në sallën e seancës me pranga në duar.

75. Më 9 qershor 2015, Kryeministri postoi një mesazh në Twitter ku i referohej “parave të pista që furnizonin” shoqërinë e kërkuesve. Gjithashtu më 12, 15 dhe 17 qershor 2015 ai mori pjesë në disa programe televizive ku komentoi hetimin për pastrimin e parave në Shqipëri.

76. Më 23 shkurt 2022, kërkuesit u dënuan në shkallë të parë. Të gjithë kërkuesit e ankimuan vendimin në apel ku vendimi është akoma në pritje.

B. Praktika dhe legjislacioni përkatës i brendshëm

77. Ligji nr. 8328/1998, në fuqi në momentin në fjalë, parashikonte mbrotjtjen e të drejtave themelore të të paraburgosurve, sidomos mbrotjtjen e tyre nga trajtimi çnjerëzor ose poshtërues. Neni 57 dhe 58 i ligjit rregullon përdorimin e masave kufizuese, sidomos përdorimin e prangave

gjatë transferimit të të paraburgosurve. Sipas nenit 71, gjykata kompetente e rrethit shqyrton çdo ankim në lidhje me “çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e të paraburgosurve” nëse Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon ndryshe.

78. Në vendimin e saj nr. 57 të 21 dhjetorit 2012, Gjkata Kushtetuese konsideroi prezumimin e pafajësisë (të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës) si një nga elementët përbërës të gjykimit të drejtë.

79. Në vendimin e saj nr. 47 të 7 nëntorit 2011, Gjkata Kushtetuese theksoi që parimi i prezumimit të pafajësisë konsiderohej i shkelur nëse një vendim i gjykatës pasqyronte mendimin që i akuzuari ishte fajtor përpara se të provohej fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk kishte një deklaratë formale për këtë qëllim, mjaftonte që arsyetimi nënkuptonte se i akuzuari ishte fajtor.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Shkelja e pretenduar e nenit 3 të Konventës

80. Qeveria pretendoi se kërkesja e katërt nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore sepse ajo duhej të kishte depozituar një padi civile për dëmshpërblim.

81. Gjkata vëren që keqtrajtimi i pretenduar i kërkeses së katërt kishte të bënte me prangosjen e saj gjatë transferimit nga paraburgimi në gjykatë dhe gjatë një seance dhe fotografimin e saj nga përfaqësuesit e media ndërkohë që ishte me pranga në duar. Gjkata konsideron që, edhe nëse supozojmë se trajtimi në fjalë ka arritur në nivelin e rëndësës për zbatimin e nenit 3 (krahasoni *çështja Kashavelov kundër Bullgarisë*, nr. 891/05, 38-40, 20 janar 2011, dhe *çështja Pranjić-M-Lukić kundër Bosnjë Hercegovinës*, nr. 4938/16, § 72, 2 qershor 2020), nuk mund të konsiderohet që ky trajtim do të kërkonte ndjekjen penale të personave përgjegjës. Sipas Gjykatës, padia civile për dëmshpërblim do të ishte e mjaftueshme në rrethanat e çështjes në fjalë. Megjithatë Gjkata vëren që kërkesja nuk ka depozituar padi civile për dëmshpërblim dhe/ose një ankim sipas ligjit nr. 8328 (shihni paragrafin 6 më sipër), dhe as nuk e ka çuar situatën në ndonjë formë tjetër në vëmendje të autoriteteve (krahasoni *çështja Radkov dhe Sabev kundër Bullgarisë*, nr. 18938/07 dhe 36069/09, § 38, 27 maj 2014, dhe *çështja Costiniu kundër Rumanisë* (dec.), nr. 22016/10, § 29, 10 shkurt 2013).

82. Në këto rrethana, ky ankim duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Kushtetutës për moshterimin e mjeteve të brendshme ligjore.

B. Shkelja e dyshuar e nenit 6 § 2 të Konventës

83. Qeveria kundërshtoi që kërkesit nuk kishin provuar ndonjë mjet ligjor në lidhje me ankimin e tyre sipas nenit 6 paragrafi 2 të Konventës për shkeljen e prezumimit të pafajësisë së tyre nga disa deklarata të Kryeministrit, as në kuadër të procesit penal kundër tyre, as në procese të ndara civile me anë të depozitimit të pretendimit për dëmshpërblim.

84. Kërkesit argumentuan që nuk ekzistonin mjete të efektshme ligjore në Shqipëri në lidhje me ankimin e tyre sipas nenit 6, paragrafi 2, të Konventës dhe që asnjë prej mjeteve të treguara nga Qeveria nuk do të kishte ndonjë mundësi suksesi. Ata gjithashtu pretenduan që një mjet ligjor mund të ishte përdorur për të kundërshtuar vendimet, por jo deklaratat e zyrtarëve publikë në media.

85. Gjkata rikujton që parimi i prezumimit të pafajësisë mbi të gjitha është garanci procedurale, dhe një nga elementët e një gjykimi të drejtë penal të kërkuar nga neni 6 § 1 (shihni *çështja Allenet de Ribemont kundër Francës*, 10 shkurt 1995, § 35, seria A nr. 308; *çështja Konstas kundër Greqisë*, nr. 53466/07, § 29, 24 maj 2011; dhe *çështja Mamaladze kundër Gjeorgjisë*, nr. 9487/19, § 63-65, 3 nëntor 2022).

86. Më tej, Gjkata vëren që Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Shqipëri, e drejta e prezumimit të pafajësisë garantohet edhe në Kodin Penal edhe në Kushtetutën e Shqipërisë dhe që praktika e Gjykatës Kushtetuese tregon që e ka trajtuar këtë temë si një aspekt të një gjykimi të drejtë (shihni paragrafët 6 dhe 7 më sipër). Proceset penale kundër kërkesve janë akoma në pritje. Ata mund të ngrenë çështjen e përputhshmërisë së deklaratave të kontestuara të Kryeministrit me të

drejtën e tyre për t'u prezumuar të pafajshëm në kuadër të procesit penal kundër tyre dhe, sipas rastit, përpara Gjykatës Kushtetuese. Gjykata është shprehur tashmë që ankimi kushtetues në parim është një mjet ligjor i efektshëm dhe prandaj kërkohet për qëllime shteruese në lidhje me të drejtën e një kërkuesi për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës (shihni, *mutatis mutandis*, *çështja Balliu kundër Shqipërisë* (dec.), nr. 74727/01, 30 shtator 2004; *çështja Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, §§ 30-34, 22 gusht 2006; *çështja Jakupi kundër Shqipërisë* (dec.), nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009; dhe për një konkluzion të ngjashëm, *çështja Muçaj kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 37814/10, § 26, 11 korrik 2023). Asnjë parashikim në legjislacionin e brendshëm nuk sugjeron që deklaratat e zyrtarëve publikë dhe që ndikimi i tyre i pretenduar mbi të drejtën e të pandehurit për prezumimin e pafajësisë nuk mund të jetë objekt rishikimi nga gjykatat penale, ose, sipas rastit në përfundim, nga Gjykata Kushtetuese (krahasoni *çështja Ringwald kundër Kroacisë* (dec.) [Cte], nr. 14590/15 dhe 25405/15, § 52, 22 janar 2019). Gjithashtu, praktika e Gjykatës Kushtetuese në veçanti përmban mundësinë e rishikimit të situatave faktike që mund të ndikojnë te të drejtat kushtetuese, siç janë pretendimet për kohëzgjatje të procesit penal (shihni *çështja Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 35, 12 tetor 2021).

87. Megjithatë, kërkuesit nuk kanë paraqitur ankimin e tyre sipas nenit 6 paragrafi 2 të Konventës brenda kuadrit të procesit penal kundër tyre dhe as nuk kanë depozituar një ankim kushtetues në këtë drejtim. Në lidhje me pretendimin e kërkuesve që asnjë nga mjetet ligjore të mësipërme nuk do të kishte mundësi suksesi, Gjykata përsërit se thjesht dyshimet e kërkuesve në lidhje me mundësinë e suksesit dhe efektshmërinë e mjeteve të brendshme ligjore në dispozicion, të pambështetura me prova bindëse, nuk janë arsye e pranueshme për mospërdorimin e këtyre mjeteve ligjore (shihni *çështja Kunqurova kundër Azerbaixhanit* (dec.), nr. 5117/03, 23 qershor 2005; *çështja Guliyev dhe Ramazanov kundër Azerbaixhanit* (dec.), nr. 34553/02, 14 shkurt 2006; dhe *çështja Costiniu*, të cituar më sipër, § 28).

88. Për rrjedhojë, ky ankim është i parakohshëm dhe në këto rrethana duhet të refuzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

Shpall kërkesën të pranueshme.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim, më 19 tetor 2023.

Olga Chernishova
Zëvendëskancelare

Georgios A. Serghides
President

SHTOJCË

Lista e kërkuesve:

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Shtetësia	Vendi i qëndrimit
1.	Francesco BECCHETTI	1966	italian	Londër
2.	Liliana CONDOMITI	1941	italiane	Londër
3.	Mauro DE RENZIS	1955	italian	Romë
4.	Erjona TROPLINI	1978	shqiptare	Tiranë

